

VENDIM
Nr. 354, datë 19.4.2017

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2017, NDËRMJET
MINISTRISË SË MJEDISIT DHE MINISTRISË SË FINANCIVE, PËR PËRBALLIMIN
E PJESSHËM TË KOSTOVE TË EKSPERTIMIT E TË PËRFAQËSIMIT TË
AVOKATËVE TË KONTRAKTUAR PËR PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË
ÇËSHTJET E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR ICSID, NR.ARB/14/26, ME PALË
“ALBANIABEG AMBIENT”, SHPK., “M.ANGELO NOVELLI” DHE
“CONSTRUZIONI”, SRL KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2017 të bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Financave, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Mjedisit t’i shtohet fondi për shpenzime korrente, në masën 41 000 000 (dyzet e një milionë) lekë, në programin 05320, “Mbrojtja e mjedisit”, për të përballuar pjesërisht kostot e ekspertimit e të përfaqësimit të avokatëve të kontraktuar nga ana e shtetit shqiptar për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar ICSID, nr.ARB/14/26, me palë “Albaniabeg Ambient”, sh.p.k., M.Angelo Novelli dhe “Construzioni”, s.r.l, kundër Shqipërisë;

b) Ministrisë së Financave, në zërin “shpenzime korrente”, t’i pakësohen fondet, përkatësisht:

i) 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, në programin 01110 “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”;

ii) 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekë, në programin 01120 “Menaxhimi i shpenzimeve publike”.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi